

## **TARKA (Trandolapril/ verapamil)**



Tarka përdoret për trajtimin e presionit të lartë të gjakut tek pacientët të cilët presioni i lartë i gjakut tashmë është i kontrolluar në kombinim me verapamil SR dhe trandolapril.

Tarka i takon grupit të antihipertensivëve. Përmban dy lloje të ndryshme barnash:

- **Një kalciblokues (verapamil)**

- **Një ACE- inhibitor (trandolapril)**

**Mekanizmi i veprimit të kalciblokuesit dhe ACE I është veprim komplementar (plotësues të njëri-tjetrit)**

Ul rezistencën periferike . Efekt inotrop dhe kronotrop negativ (ul kontraktilitetin dhe ul frekuencën)

ACE-inhibitor frenojnë kthimin e angiotensinës I në angiotensinë II duke frenuar enzimën konvertuese

### **VEPRIMI TE PACIENTI**

#### **VERAPAMIL**

Presioni i gjakut:

- Vazodilatacion
  - Redukton fluksin e kalciumit në qelizat e muskujve kardiak
  - Frenon aktivizimin e sistemit simpatik
  - Redukton clirimin e katekolaminave
- Efektivitet të lartë në pacientët me përqëndrim të ulët të reninës

#### **Trandolapril**

- Vazodilatacion
  - Redukton prodhimin e angiotenzinës II (Vazokonstriksion) dhe redukton degradimin e bradikininës
  - Frenon aktivizimin e sistemit simpatik
  - Frenojnë sistemin renin-angiotensinë-aldosteron
- Efektivitet të lartë në pacientët me përqëndrim të lartë të reninës

### **VEPRIMI I TYRE NË METABOLIZËM DHE VESHKA**

#### **VERAPAMIL**

Metabolizëm:

- Efekt neutral në profilin e lipideve
- Efekt neutral në metabolizmin e glukozës

Veshka:

- Ul glomerulosklerozen
- Redukton albuminurinë

### **TRANDOLAPRIL**

Metabolizëm:

- Efekt neutral në profilin e lipideve
- Përmireson ndjeshmërinë e insulinës

Veshka;

- Ul glomerulosklerozen
- Frenon sistemin renin-angiotensin-aldosteron
- Redukton albuminurinë

### **VEPRIMI I TYRE NE ZEMËR**

**Verapamil- ZEMRÀ:**

- Efekt ne kontrollin e rritmit
- Zvogëlon LVH(left ventrikular hipertrofi)
- Antianginoz/ veprim antiarritmik
- Përmirëson funksionin diastolik

**TRANDALOPRIL-ZEMRÀ:**

- Ndikim pozitiv në zemer të dëmtuar
- Frenon sistemin renin-angiotensin- aldosteron në zemër
- Përmirëson funksionin Sistolik

### **DOZIMI:**

Verapamil: Doza maksimale ditore në studim është 480 mg

Trandalopril: Doza maksimale ditore në studim është 4 mg

**Doza maksimale ditore e Tarkës është: Tarka 180/2 mg dhe 240/4 mg**

**Kontrollon presionin e gjakut me një dozë ditore për 24 orë**

### **AVANTAZHET E KOMBINIMIT DOZË-FIKSE**

#### **PACIENTI**

- ❖ Trajtim me një dozë të vetme
- ❖ E përshtatshme,
- ❖ E lehtë për t'u marrë
- ❖ Prezantim në një tabletë të vetme

#### **MJEKU SPECIALIST**

- ❖ Kompliancë të lartë tek pacienti
- ❖ Kombinimi i dozës fikse ofron efikasitet më të mirë dhe një profil tolerance në një numër të gjerë pacientësh hipertensive
- ❖ Besimi se pacientet po marrin kombinimin më të dobishëm të dy përbërësve
- ❖ E lehtë për t'u pershkruar

Zgjedhje efektive për pacientët që nuk kontrollohen me monoterapi

Vepron në një spektër të gjerë të pacientëve antihipertensive

Efikasitet afatgjatë në një sëmundje afatgjatë.

Ofron mbrojtje të jashtëzakonshme të veshkave.

Redukton mikroalbuminurinë në pacientët diabetik.

Zgjeron mundësitë e menaxhimit të pacientëve hipertensivë me sëmundje të arterieve koronare.

Redukton mikroalbuminurinë në pacientët diabetik.

Ofron mbrojtje kardiovaskulare.

### **KUR NUK DUHET TË MERNI TARKA**

Nëse jeni alergjik ndaj cdo frenues tjetër ACE.

Nëse presioni juaj i gjakut është shumë i ulët.

Nëse keni rrahje zemre të parregullta .

Nëse keni Kardiomiopati obstruktive.

Nëse jeni në dializë.

Nëse jeni shtatzënë .

Nëse jeni duke u trajtuar me beta-blokues injeksion.

### **EFEKTET ANËSORE TË TARKËS**

Efekte që mund të shfaqen 1 në 10 persona.

- Kollë.
- Marrje mendsh,
- Dhimbje koke
- Konstipacion
- Presion shumë të ulët të gjakut
- Tensioni i ulët i gjakut kur ju qëndroni ose ngriheni në këmbë